

Informacion i Përgjithshëm për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

NLB Banka në vazhdimësi zhvillon dhe përmirëson shërbimet e saj, me qëllim të përmbushjes së kërkesave të klientëve. Andaj, grumbullimi dhe përpunimi i disa të dhënave personale na mundëson që t'ju përshtatemi nevojave dhe preferencave tuaja më shpejtë dhe më mirë; për ju, ato mundësojnë komunikim më efektiv me ne dhe përvojë më të mirë me klientë.

Mbrojtja e privatësisë tuaj është e rëndësishme për ne, prandaj, ne ju ofrojmë këtë informacion për t'ju ndihmuar që të kuptoni se cilat të dhëna tuaja personale i grumbullojmë, përse i grumbullojmë ato, si i përdorim ato, cilat procedura të përpunimit i zbatojmë, cilat janë të drejtat tuaja dhe si mund t'i përdorni ato.

Ne i ruajmë dhe mbrojmë të dhënat personale në mënyrë që të parandalohet çfarëdo shpalesje e panevojshme e të dhënave personale të paautorizuara. Ne nuk bëjmë transferim, huazim apo shitje të të dhënave personale palëve të treta pa paralajmërim dhe pa pasur paraprakisht pëlqimin tuaj. Në të gjitha rastet, ne do të sigurojmë masat adekuate të sigurisë dhe përpunojmë të dhënat personale vetëm brenda kornizave ligjore dhe për qëllime të caktuara.

Të dhënat personale janë çfarëdo informate në lidhje me një person të identifikuar apo të identifikueshëm (subjekt i të dhënave).

1.Kush është përgjegjës për menaxhimin e të dhënave tuaja personale?

Mbikëqyrësi i të dhënave tuaja personale është:

NLB Banka Prishtina, rruga Ukshin Hoti, numër 124, 10000, Prishtina (në tekstin në vijim: NLB Banka).

2. Kush mund t'ju jap shpjegime tjera ose informacione rreth përpunimit të të dhënave personale dhe të drejtave tuaja?

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në NLB Banka, me të dhënat e mëposhtme:

Email: dpoprishtina@nlb-kos.com

Numër kontaktues: 038 240 230 100

Postë: NLB Banka SH.A, rruga Ukshin Hoti, numër 124, 10000, Prishtinë.

3. Kur ne mundemi të përpunojmë të dhënat tuaja personale?

3.1 Për të lidhur dhe zbatuar kontratën me ju

NLB Banka përpunon të dhënat personale për të realizuar shërbimet bankare individuale siç janë: hapja dhe administrimi i llogarive, depozitave, debitimeve direkte dhe shumat e mbajtura, bërja e pagesave, skema të ndryshme të kursimit, kreditë, garancionet, letër kreditë, blerja e letrave me vlerë, sigurimet, shërbimet e agjentit të bursave, dërgimi i SMS mesazheve lidhur

me bilancin e llogarisë dhe transaksionet e kryera me kartela, procedimi i ankesave dhe menaxhimi i kontakteve me individë duke përdorur kanale të ndryshme të komunikimit.

Kur NLB Banka kryen pagesa ndërkombëtare përmes bankave korrespondente ose shkëmben mesazhe me qëllim të zgjidhjes së ankesave ose garancioneve e materialit dokumentar, të dhënat mund të përpunohen nga SWIFT (S.W.I.F.T. SC, Avenue Adele 1, 1310 La Hulpe, Belgium), që ofron rrjetin për lidhjen mes bankave - Society for Worldwide Interbank Financial Telecommunication. Në këtë rast, NLB Banka dhe SWIFT veprojnë si kontrollues të përbashkët (për më shumë informacione mund të shihni në këtë link: https://www2.swift.com/knowledgecentre/publications/s_pdp_pol/1.0).

3.2 Kur kërkohet nga ligji

NLB Banka përpunon të dhënat personale për të përmbushur kërkesa ligjore dhe rregullatore, në veçanti ato që rregullojnë shërbimet bankare dhe të pagesave, dhe ligjet relevante evropiane, në veçanti obligimet për raportim, verifikimi i klientit (parandalimi i shpërlarjes së parave) dhe menaxhimi i riskut. Për shembull: Banka mund të kërkojë dhe të marrë informata lidhur me të dhënat tuaja personale dhe të dhëna tjera, si: të dhënat e punësimit, pronës së luajtshme dhe të paluajtshme, të hyrat, interesat, kërkesat, aksionet dhe letrat tjera me vlerë, numrat e llogarive në bankat tjera apo institucionet tjera të pagesave, pronat tjera, numri tatimor dhe të dhënat tjera nga burimet tjera në rast se NLB Banka nuk i ka poseduar këto të dhëna ose nëse ju nuk i keni dorëzuar ato personalisht në Bankë përkundër kërkesës së saj, e që ato të dhëna nevojiten për të përmbushur obligimet kontraktuale apo kërkesat ligjore.

3.3 Kur ka arsye reale dhe të bazuar

NLB Banka poashtu përpunon të dhënat personale bazuar në interesin ligjor, që tregon përgjegjësinë tonë ndaj jush dhe mirëmban një sërë shërbimesh të ofruara në treg të cilat do të përmbushin pritshmërinë tuaj, ku me kujdes matim interesat tona karshi të drejtave tuaja për privatësi. Shembuj të përpunimit bazuar në interesin ligjor:

- Masat për të parandaluar, detektuar dhe hetuar mashtrimet dhe veprimet tjera të dëmshme;
- Video vëzhgim (për shembull në njësi ose bankomat) dhe masa të ngjashme, në veçanti, për të dëshmuar transaksionin dhe për të siguruar mbrojtjen e pasurisë së klientëve dhe të punësuarve;
- Regjistrimi i telefonatave apo video bisedave (për shembull kur të lidhen marrëveshjet, në raste të ankesave etj);
- Masat e zhvillimit të produktit dhe menaxhimit;
- Në komunikime me klientë të korporatave;
- Në hulumtim të tregut, analiza të biznesit dhe analizat që kanë për qëllim marrjen e vendimeve.

3.4 Kur ju jepni pëlqimin tuaj

Përpunimi i të dhënave personale mund të bazohet në pëlqimin e dhënë nga individ, i cili lejon që NLB Banka të përdor të dhënat e tij/saj personale për qëllime të përcaktuara në pëlqim, saktësisht:

Për aktivitete të marketingut, siç janë dërgimi i lajmeve, njoftimeve të përgjithshme lidhur me produktet, të rejat, përfitimet, ngjarjet, lojëra shpërblyese dhe lajme tjera të rëndësishme për shfrytëzuesit individual të shërbimeve bankare dhe për publikun e gjerë;

Për të dërguar informacione lidhur me shërbimet, produktet e reja dhe ofertat speciale të përshtatura për interesat tuaja, bazuar në profilizimin e përdorur nga NLB Banka për këtë qëllim. Profilizimi, për shembull, formatimi i profilit do të thotë përdorimi i të dhënave personale për të përlogaritur aspektet e caktuara personale që ndërlidhen me individin ose grupin e individëve, në veçanti për të analizuar ose llogaritur performancën e punës, situatën ekonomike, shijen personale, interesat, shprehitë, besueshmërinë, sjelljen, lokacionin ose lëvizjet e individit;

Për të realizuar anketë ose pyetësor për kontrollimin e kënaqësisë, përdorimit të shërbimeve dhe kanaleve të marketingut me qëllim të përshtatjes dhe përmirësimit të produkteve/shërbimeve;

Këto qëllime përfshijnë përmbajtjen lidhur me NLB Bankën, ndërsa të dhënat tuaja nuk do t'i jepen kompanive nga NLB Grupi dhe partnerëve të kontraktuar të NLB Bankës.

Nëse nuk e jepni pëlqimin për përpunimin e të dhënave personale për këto qëllime, e jepni pjesërisht ose pjesërisht e anuloni/tërhiqni pëlqimin, ne do t'ju njoftojmë vetëm në rastet dhe brenda pëlqimit tuaj të dhënë, në mënyrat e lejuara me ligjin e aplikuar (siç janë njoftimet e përgjithshme, për të përmbushur banka obligimet e veta lidhur me shërbimet që jeni duke i shfrytëzuar);

Pëlqimi duhet të jepet me vullnet të lirë, dhe nëse vendosni që nuk do të doni më, ose dëshironi të anuloni më vonë pëlqimin, kjo nuk do të dëmtojë të drejtat tuaj që dalin nga bashkëpunimi afarist me NLB Bankën dhe nuk do të paraqesë shpenzime shtesë ose situatë të pakëndshme. Lidhja e kontratës dhe provizioni i shërbimeve bankare nuk varet nga dhënia e pëlqimit.

4. Si i mbledhim të dhënat dhe cilat lloje të të dhënave personale përpunohen?

NLB Banka mbledh të dhënat personale nga burime të ndryshme. Në të shumtën e rasteve, këto të dhëna jepen direkt nga klientët të cilët përzgjedhin ndonjë shërbim bankar individual. Po ashtu të dhënat personale mund të mblidhen në mënyrë indirekte përmes përdorimit të shërbimeve bankare. NLB Banka nxjerr disa të dhëna duke përpunuar të dhëna për raporte, analiza, etj. NLB Banka mund të shfrytëzojë informacione tjera mbi personat, të cilat mund të qasen apo janë dërguar tek ne përmes burimeve publike (regjistrat publik, baza të dhënash, aplikacione në internet, aplikacione mobile, rrjete sociale apo burime tjera publike të informacioneve). Të gjitha të dhënat dhe informacionet e mbledhura përpunohen nga punonjësit e Bankës vetëm në kuadër të punës sonë.

NLB Banka përpunon këto lloje të të dhënave personale:

Të dhënat bazike të identifikimit dhe të dhënat tjera të identifikimit dhe kontaktit

Të dhënat personale si: emri dhe mbiemri, data e lindjes, vendbanimi, numri personal, numri tatimor, numri i telefonit, e-mail-i (e cila na nevojitet për dërgimin e mesazheve tek ju, përndryshe, ju nuk do të informoheni për ofertat speciale dhe gamën e produkteve/shërbimeve

pa pasur pëlqim paraprakisht). Këto janë të dhënat bazike të identifikimit dhe të kontaktit të cilat kërkohen për të përfunduar biznesin apo për dërgimin e njoftimeve për ofertë.

Informatat sociale-demografike

Këto janë të dhëna standarde statistikore, p.sh, moshë, adresa e vendbanimit, gjinia, niveli i edukimit, të ardhurat etj. Këto të dhëna zakonisht zbulohen në momentin kur ju filloni të shfrytëzoni shërbimet tona, apo i nxjerrim nga të dhënat e tjera të disponueshme.

Informatat në lidhje me kompanitë tjera

Kur bëni kërkesë për kredi, duhet të listohet burimi i të ardhurave tuaja. Nëse jeni i punësuar, NLB Banka kërkon nga ju që të cekni punëdhënësin, nëse dispononi ndonjë kompani, duhet të ceket emri i kompanisë suaj. Nëse ju nuk keni aplikuar asnjëherë më parë për kredi në NLB Banka, banka nuk e din nëse ju jeni i punësuar apo nga kush, apo nëse jeni i vetë-punësuar. Ngjashëm, NLB Banka mund të gjejë shërbime të përshtatshme për të gjithë familjen, nëse kemi informata që të afërmit tuaj kanë llogari në NLB Banka.

Të dhënat mbi transaksionet

Sistemet e NLB Banka regjistrojnë çdo pagesë të bërë nga llogaria juaj, nga karta e debitit apo kreditit, online, përmes m-banking, po ashtu çdo tërheqje nga ATM, transaksionet e bëra në emrin tuaj me kërkesën tuaj, dhe pagesat e bëra në llogarinë tuaj. Çdo transaksion përmban të dhëna shtesë, si shumën e transaksionit, numrin e llogarisë së dërgesës, emrin dhe numrin e POS terminalit në dyqan (merchant) të shfrytëzuar për kryerjen e pagesës, adresën apo lokacionin e dyqanit (merchant), datën dhe kohën e pagesës, si dhe tekstin apo komentin. Nga këto të dhëna NLB Banka mund të krijojë konkluzione në lidhje me sjelljen tuaj sa i përket transaksioneve, p.sh sa shpesh ju paguani me kartel në vend të tërheqjes së parave nga ATM, sa shpesh, ku, cilat janë të ardhurat tuaja, nëse të ardhurat tuaja vijnë nga disa punëdhënës, në cilat dyqane blini, sa paguani për blerjet tuaja, etj. Të gjitha këto informacione i ndihmojnë NLB-së që t'ju ofrojë shërbime të qasshme dhe të dobishme.

Informacion rreth kanaleve dhe aplikacioneve të përdorura

Ju mund të kontaktoni NLB-në nëpërmjet disa kanaleve të komunikimit dhe pika të shitjes (telefon, online banking, aplikacionet web dhe mobile të NLB-së, etj.) Gjatë regjistrimit, transaksioneve dhe aktiviteteve tjera, kompjuteri juaj në mënyrë automatike dërgon IP adresën tek serveri i NLB-së ku jeni qasur. Në këtë mënyrë, NLB Banka mund të identifikojë numrin e rrjetës dhe nën-rrjetës në të cilën është i lokalizuar kompjuteri juaj. Nëse ju keni lejuar përdorimin e “cookies” në shfletuesin tuaj, do të ju mundësojnë operimin e lehtë të web faqes me të gjitha funksionalitetet dhe eksperiencë më të mirë tek përdoruesi. NLB Banka mund të përcaktojë kohëzgjatjen e kyçjes suaj (login), cilat veprime keni kryer në aplikacion, cilat të dhëna i keni futur në formë – të gjitha këto bëhen për shkaqe të sigurisë. Informacionet rreth sistemit tuaj operativ dhe versionin e tij, si dhe të dhënat teknike në lidhje me pajisjen tuaj që jeni duke e shfrytëzuar, ndihmojnë që të sigurohemi që web faqet dhe shërbimet tona do të paraqiten në mënyrë të saktë në pajisjen tuaj, pasi që kjo është e vetmja mënyrë që në vazhdimësi të përmirësojmë shërbimet dhe ti adaptojmë ato për nevojat e juaja teknike.

Informacioni në lidhje me përdorimin tuaj të shërbimeve të NLB Bankës dhe anëtarëve të tjerë të Grupit NLB

Për aktivitetet e targetuara, NLB shfrytëzon informacionin se cilat shërbime të NLB-së apo pjesëtarëve tjerë të NLB grupit aktualisht i shfrytëzoni, për sa gjatë, nën cilat kushte, nëse jeni duke i shfrytëzuar apo i keni mbyllur ato. Banka kupton sa shpesh dhe ku i përdorni kartat e pagesave të lëshuara nga NLB, në çfarë shume dhe për çfarë qëllimi janë kryer këto pagesa. Nëse keni marrë një hua nga Banka, ne mund të përdorim informacionin në lidhje me shumën dhe datën e një kësti të caktuar. Nëse keni ndonjë llogari të kursimeve në Bankën tonë, kuptojmë sa shpesh dhe çfarë shume dërgoni në të. Në mjediset online, telefon, NLB Banka mbledh informatat rreth opsioneve që ju keni përzgjedhur (fushat e përzgjedhura, llojin e informacionit të futur dhe format, etj.) Banka po ashtu përpunon informacionin se sa shpesh ju regjistrohni në aplikacionet online, aplikacionet bankare mobile, telefon dhe nëse keni kryer ndonjë veprim gjatë kohës sa keni qenë të kyçur (p.sh, nëse keni kryer ndonjë pagesë, etj.).

Kontaktet me Bankë

Banka mban shënime rreth kontakteve tona me ju, posaçërisht datën (mundësisht edhe kohën) e kontaktimit dhe arsyen e tij. Kjo aplikohet në të gjitha kontaktet (telefon, video, SMS, postë, postë elektronike, zyre në degë dhe të tjera). Banka regjistron këto kontakte në mënyrë që të shmangim thirrjet e shumëfishta për të njëjtin qëllim. Çdo herë që ju njoftojmë për ndonjë ofertë, ne ruajmë këtë informacion nëse keni pranuar apo jo, që të shmangim mundësin e ofrimit të njëjtave produkte disa herë. Ne po ashtu mbajmë shënime në rastet kur ju keni pasur biseda me këshilltarët dhe zyrtaret tjerë të NLB Bankës.

Rrjetet Sociale

Për fushatat e marketingut banka shfrytëzon edhe rrjetet sociale siç është Facebook, edhe pse banka nuk ruan të dhëna të publikuara në profilin tuaj, ne i shfrytëzojmë ato për të përmirësuar aktivitetet e reklamave të shenjëstruara, kuptohet vetëm nëse ju pajtoheni me këtë kur i shfrytëzoni këto rrjete sociale. Për bankën, rrjetet sociale janë një kanal për t'ju adresuar klientëve, dhe shenjëstrimi është një vlerë e shtuar. Në kontekstin e "cookies" të palëve të treta, ne ofrojmë një eksperiencë edhe më të mirë të shfrytëzuesit, shpërndarjen e përmbajtjes në rrjetet e ndryshme sociale, si dhe përshtatjen e ofertës sonë dëshirave dhe nevojave tuaj, që mund të lexohen nga shfletimet e mëhershme. Të dhënat e mbledhura me ndihmën e këtyre "cookies" janë të disponueshme për NLB-në si dhe për ofruesit e shërbimeve.

Shënimet e komunikimit

Në rastet kur ju kontaktoni NLB-në përmes telefonit apo video thirrjes, ne mund të kërkojmë nga ju pajtueshmërinë që kjo thirrje të regjistrohet. Në disa raste thirrjet duhet të regjistrohen, sepse kjo është një kërkesë ligjore, ose që të mund të dëshmohet se banka ka ndjekur udhëzimet e juaja, ose që kontrata është zbatuar në mënyrë të rregullt, ose që banka është duke vepruar në pajtueshmëri me rregulloret ligjore. Ju jeni të informuar paraprakisht për regjistrimin.

Të dhënat mbi gjeo-lokacionin

Informacioni për pagesat e bëra me instrumente për pagesë të NLB-së (debit apo kredit kartelë, online, telefon) dhe aplikacionet që përdoren për "mobile banking" përmbajnë të dhëna për gjeo-lokacionin. Këto të dhëna përcaktojnë në mënyrë ta saktë koordinatat e GPS (ose adresën e pikës të ndonjë transaksion, varësisht nga lokacioni fizik i terminalit për pagesë në dyqan (merchant). Në regjistrim, ne lexojmë lokacionin tuaj nga gjurmë specifike. Banka shfrytëzon

të dhënat për gjeo-lokacionin në rastet kur ju vizitoni web faqet dhe kur ju shfrytëzoni aplikacionet mobile të NLB-së, duke ju ofruar ju informacionin e kontaktit dhe të ju ndihmojë që të gjeni këshilltarin bankar apo degën më të afërt të bankës.

Informacioni në lidhje me aftësinë tuaj të kreditit

Kur aplikoni për kredi, ligji dhe akte tjera normative procedurale kërkojnë nga banka që të kontrollojë aftësinë tuaj për kredi dhe historinë kreditore (creditworthiness) në sistemin ZRK (Zyra e Regjistratit të Kredive). Ky informacion shfrytëzohet për të llogaritur aftësinë tuaj që të paguani kredinë. Përveç informacioneve në sistemin ZRK, për të llogaritur aftësinë tuaj kreditore banka shfrytëzon edhe informacionet e ruajtura në sistemet e saj (informacione në lidhje me veprimet me llogaritë personale, pagesat e kredive të më hershme) dhe nga sistemet e bankës të kontraktuara për përpunim të të dhënave. Bazuar në këto të dhëna banka mund të ju ofroj kredinë me karakteristikat që vlerëson që është më e mira për ju.

Burimet e jashtme

Banka dëshiron të sigurohet që oferta e saj është e përshtatshme për ju. Ndonjëherë banka shfrytëzon të dhëna nga burimet e jashtme, në rast se të dhënat e saj nuk janë ta mjaftueshme për shënjestrim. Këto burime përfshijnë kryesisht regjistrat dhe shënimet publike (p.sh. regjistri i identifikimit të bizneseve, ZRK etj.).

Sondazhet, hulumtimet dhe testimet e përdoruesve

Banka është e interesuar për opinionin e klientëve të saj në lidhje me shërbimet ekzistuese dhe reklamat, çfarë shërbimi dëshirojnë, për këtë arsye banka dëshiron të ju pyes për këtë në sondazhe dhe hulumtime. Në këtë mënyrë, zakonisht merren rezultatet mesatare që përfaqësojnë të gjithë grupin e të anketuarve. Gjatë zhvillimit të shërbimeve të reja, shfrytëzohen edhe metoda tjera, p.sh. pyeten klientët se si do ti donin versionet e reja të aplikacioneve, zhvillohet e ashtuquajtura testim i shfrytëzuesit, për të kuptuar nëse shërbimi i ri është atraktiv dhe i lehtë për tu përdorur.

Të dhënat dhe informatat që përpunojmë në mënyrë që të veprojmë në vijë me obligimet tona ligjore

Këto janë të dhëna të cilat banka duhet ti mbledh, vlerësoj dhe ruaj për një kohë të caktuar, që të veproj në vijë me obligimet e saj ligjore. Këto të dhëna janë p.sh. obligimi i arkivimit të të dhënave nën disa ligje që rregullojnë aktivitetet biznesore, ose mbledhja dhe vlerësimi i të dhënave për të parandaluar shpërlarjen e parave, financimin e terrorizmit, dhe obligime tjera ligjore. Këto të dhëna mund të përfshijnë p.sh burimin dhe origjinën e të ardhurave tuaja, lidhjet reciproke të kapitalit, nacionalitetin, nënshtetësinë, adresën e vendbanimit, fushën e aktivitetit, ekspozimin politik etj. Bazuar në pajtueshmërinë tuaj, apo nëse ekziston ndonjë tjetër bazë ligjore, banka mund të shfrytëzoj këto të dhëna edhe për qëllime tjera, në pajtueshmëri me dëshirat tuaja.

5. Kush mund t'i përdor të dhënat personale që ju i keni dhënë në NLB?

Të punësuarit e NLB-së

Të dhënat tuaja personale përpunohen nga sistemet e NLB-së dhe të punësuarit individualë të cilët i kërkojnë këto të dhëna për punën e tyre dhe mund t'i ndajnë me të punësuarit tjerë. Kjo do të thotë që çdo informacion që i keni dhënë këshilltarit të bankës do të jetë në dispozicion edhe për të punësuarit tjerë të NLB-së, për shembull, të punësuarit në marketing, për qëllime marketingu.

Përpunuesit e të dhënave kontraktuale

Përveç të punësuarve në NLB, përdoruesit e të dhënave personale janë gjithashtu të punësuarit e përpunuesve të të dhënave kontraktuale të Bankës të cilët mund të përpunojnë të dhënat tuaja vetëm në përputhje me ligjin relevant, me aprovimin ose pëlqimin e juaj. Këto janë për shembull printera që shtypin njoftime të ndryshme dhe materiale reklamuese të dërguara tek ju me anë të postës. Një shembull tjetër janë operatorët e telekomunikacionit të cilët ju transmetojnë mesazhet tona. Në çdo rast, ne sigurojmë mbrojtjen e të dhënave tuaja personale në të njëjtën mënyrë sikur të përpunohen nga vetë NLB.

Autoritetet shtetërore kompetente

Në raste të caktuara të cilat parashihen me ligjet në fuqi, ne duhet t'i transmetojmë të dhënat tuaja personale ose t'i raportojmë ato autoriteteve kompetente shtetërore dhe autoriteteve përgjegjëse për tatimin financiar ose mbikëqyrjen bankare (siç janë Njësia e Inteligjencës Financiare, Administrata Tatimore e Kosovës, gjykatat etj.) Po ashtu duhet t'ia përcjellim ato palëve të treta nëse ky detyrim i përcjelljes ose zbulimit është i caktuar me ligj. Detajet rreth kategorive të përdoruesve, partnerëve kontraktues dhe përpunuesve kontraktualë mund të merren me kërkesë të Zyrtarit tonë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

6. Si përpunohen të dhënat tuaja personale nga ne?

NLB Banka mund të përpunojë të dhënat manualisht ose automatikisht. Një përpunim i automatizuar i të dhënave mund të nënkuptojë gjithashtu zbatimin e të ashtuquajturit vendim-marrje të automatizuar. NLB Banka përdor disa procese të automatizuara, përfshirë formimin e profileve, ku mund të merret një vendim për një individ që rezulton me efekte juridike që lidhen me to ose që kanë një efekt të rëndësishëm në to (siç është vlerësimi i aftësisë kreditore etj.). Në rast të një vendimi të automatizuar individ do të njoftohet paraprakisht dhe do të ketë të drejtën e trajtimit personal, të drejtën për të shprehur pikëpamjen e tyre, të drejtën për të marrë një shpjegim të vendimit të bërë në këtë mënyrë dhe të drejtën për të kundërshtuar vendimin e tillë.

Për shembull, në procedurën e aplikimit online për produkte kreditore (kredit kartela etj.), vetë aplikacioni përpunon të dhënat tuaja. Para fillimit të procedurës, ju merrni të gjitha informacionet në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe nëse pajtoheni që të dhënat tuaja të përpunohen duhet të jepni pëlqimin tuaj duke plotësuar aplikacionin.

7. Cila është periudha e ruajtjes së të dhënave tuaja personale?

Periudha e ruajtjes të dhënave personale varet nga baza dhe qëllimi i përpunimit të çdo kategorie të të dhënave personale. Të dhënat personale ruhen vetëm për aq kohë sa është paraparë dhe lejuar me akte normative dhe e nevojshme për të arritur qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar. Pas arritjes së qëllimit të përpunimit dhe nëse nuk ekziston ndonjë bazë tjetër

ligjore ose nëse kjo nuk kërkohet për të zbatuar, ekzekutuar ose mbrojtur pretendimet ligjore, të dhënat personale fshihen, shkatërrohen, bllokohen ose bëhen anonime.

8. Cilat janë të drejtat tuaja mbi të dhënat personale?

Nëse dëshironi të merrni informacion rreth përpunimit të të dhënave tuaja personale, ju mund t'i kërkonti ato duke zbatuar të drejtën tuaj për qasje. Përveç kësaj, NLB ju lejon të zbatoni të drejtën e korrigjimit (për shembull nëse vini re se të dhënat tuaja personale nuk janë të sakta), të drejtën për fshirjen e të dhënave personale (për shembull nëse nuk ka bazë ligjore për përpunim) dhe të drejtën për bartje/ transferim (për shembull kur dëshironi të transferoni të dhënat tuaja personale tek një mbikëqyrës tjetër i të dhënave).

Nëse nuk pajtoheni me përpunimin e të dhënave tuaja personale në bazë të interesit tonë legjitim, ose nëse nuk dëshironi që të dhënat tuaja personale të përdoren për qëllime të marketingut të drejtpërdrejtë, ju keni të drejtë të kundërshtoni dhe të kërkonti ndërprerjen e përpunimit të të dhënave. Ju mund të paraqisni këtë kërkesë në atë mënyrë që ju të identifikoheni, domethënë duke plotësuar një formular të përgatitur për ushtrimin e çdo të drejte të tillë, që është në dispozicion në degët e Bankës ose në një mënyrë tjetër të dokumentuar (p.sh. kërkesa verbale për regjistrim në zyrën e degës së Bankës, kërkesa me shkrim, kërkesa e dërguar nëpërmjet bankës në internet ose celular). Kërkesat e pranuar përpunohen nga Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ne do t'i përgjigjemi kërkesës suaj pa vonesë të panevojshme ose më së largu brenda një muaji. Në çdo kohë ju keni të drejtë të parashtroni një ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi, adresa: rruga Zejnel Salihu, numër 22, 10000, Prishtinë, website: <https://aip.rks-gov.net>.

9. A mund të revokoni apo ndaloni pëlqimin tuaj?

Pëlqimi juaj për të përpunuar të dhënat personale për qëllimet e përshkruara në këtë informacion është vullnetar. Ju mundeni në çdo kohë të ndaloni ose të revokoni pëlqimin tuaj për përpunimin e të dhënave duke informuar NLB-në, por kjo nuk do të ndikojë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale ndërmjet juve dhe NLB-së për përdorimin e produkteve ose shërbimeve që nuk kërkojnë pëlqim të tillë.

Edhe pas heqjes së pëlqimit tuaj, NLB Banka do të përpunojë vetëm ato të dhëna që lidhen me ju, ato të dhëna që duhet të përpunojë për të përmbushur detyrimet ligjore në bazë të ekzekutimit të kontratës me ju dhe për të ndjekur interesin e tij legjitim.

10. Dispozitat përfundimtare

NLB Banka rezervon të drejtën për të ndryshuar këtë Informacion të Përgjithshëm për të siguruar përputhjen me rregulloret që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale. Ky informacion është në dispozicion në të gjitha degët e NLB Bankës dhe në faqen e saj të internetit.

Për të gjitha çështjet që nuk janë të përcaktuara shprehimisht në këtë Informacion të Përgjithshëm ose në kontratë ndërmjet Bankës dhe individit, do të zbatohen dispozitat e ligjit në fuqi.

Ky informacion i përgjithshëm vlen dhe është fuqi nga data 27 Shtator 2020.

Përditësuar më 02.04.2025.

NLB Banka sh.a. Prishtinë